



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve –Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



# Indeksi i Çmimeve të Importit

## TM3 2021

**Prishtinë, 03.12.2021** Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) gjegjësisht Departamenti i Statistikave Ekonomike ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) në qershor 2009. Çmimet e importit filluan të mblidhen në fillim të 2015. Çmimet mblidhen në bazë tremujore dhe mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave për periudhën tremujori i parë 2015 – tremujori i tretë 2021.

Publikimi përmban tabelën e Indeksit të Çmimeve të Importit në Kosovë në bazë tremujore, T1 2015 –T3 2021, mesatarja vjetore për 2015 - 2020 (2010 = 100) me ndryshime tremujore dhe vjetore në përqindje, me prezantim grafikonesh, tabela për pesha, indeksin tremujor për T3 2021, ndryshimet tremujore (T2 2021 –T3 2021) dhe ndryshimet vjetore (T3 2020 –T3 2021) për sektorët sipas Sistemit të Harmonizuar.

IÇIMP është përgatitur në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane dhe në bashkëpunim me ekspertët nga Statistika e Suedisë dhe Agjencioni Suedez i Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA).IÇIMP është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmën do të shtohen më shumë vrojtme të çmimeve.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dergoni në adresën e ueb [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

Ky publikim është përgatitur nga:

Ismajl Sahiti – Zv Drejtor i Departamentit  
Ibish Asllani - Shef divizioni  
Hamdi Jupolli - Shef Sektori

Dhjetor, 2021

Z.v i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK,  
Ilir T. Berisha

**Simbolet dhe Shkurtesat**

IÇIMP	Indeksi i Çmimeve të Importit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OBD	Organizata Botrore e Doganave
TM1	Tremujori i parë
TM2	Tremujori i dytë
TM3	Tremujori i tretë
TM4	Tremujori i katërt
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike)
Ø	Mesatare

## Përmbajtja

	Faqe
Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e tretë 2021 .....	4
Tab. 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2015–TM3 2021 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	5
Fig. 1:Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2015 – TM3 2021 (2010=100) .....	6
Tab. 2:Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar .....	7
Metodologjia .....	8.9

**Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e tretë 2021**

Indeksi i tërsishem i çmimeve të importit në Kosovë pësoi ngritje për 6,8 % në TM3 2021 krahasuar me TM2 2021. Krahasuar me TM3 2020 çmimet e importit pësuan ngritje në një mesatare prej 14,7 %.

**Tremujori i dytë 2021 – Tremujori i tretë 2021 6,8 %**

Çmimet e importit në Kosovë pësuan ngritje në një mesatare prej 6.8 % në TM3 2021 krahasuar me TM2 2021. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (33,5 %), produktet minerale (12,9 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e keramikës dhe të qelqit (4,8 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (4,4 %), druri dhe artikujt e tij (3,9 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (3,5 %), mjetet e transportit (3,0 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (2,2 %), tekstili dhe artikujt e tekstitit (1,6 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (1,5 %), produktet e industrive kimike (1,3 %), vajrat ushqyese (1,3 %), instrumentet optike, fotografik, matës, madicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (1,1 %) dhe këpucet (0,3 %).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektoreve te lekura dhe artikujt e saj (-1,1 %), produktet bimore (-1,0 %), letrat dhe artikujt e saj (-0,9 %) dhe artikujt e ndryshem të prodhuar (-0,7 %).


**Tremujori i tretë 2020 - Tremujori i tretë 2021 14,7 %**

Çmimet e Importit në Kosovë pësuan ngritje në një mesatare prej 14,7 % në mes TM3 2021 dhe TM3 2020. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (56,9 %), produktet minerale (35,8 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (19,9 %), vajrat ushqyese (13,8 %), instrumentet optike, fotografik, matës, madicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (13,5 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (11,5 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e keramikës dhe të qelqit (11,4 %), produktet bimore (9,9 %), druri dhe artikujt e tij (8,9 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (4,0 %), mjetet e transportit (3,9 %), produktet e industrive kimike (3,9 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (2,1 %), artikujt e ndryshem të prodhuar (1,6 %), dhe lekura dhe artikujt e saj (0,9 %).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektoreve te letrat dhe artikujt e saj (-3,6 %), këpucet (-3,0 %) dhe tekstili dhe artikujt e tekstitit (-1,6 %).

**Tab. 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2015–TM3 2021 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje**

Viti	Tremujori	Indeksi (2010 = 100)	Ndryshimi tremujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2015	TM 1	113,8	-0,5	-1,4
	TM 2	114,1	0,3	-0,2
	TM 3	113,9	-0,2	-0,8
	TM 4	111,8	-1,8	-2,3
	<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>113,4</b>	:	<b>-1,2</b>
2016	TM 1	108,8	-2,6	-4,4
	TM 2	109,6	0,7	-3,9
	TM 3	110,7	1,0	-2,8
	TM 4	113,2	2,2	1,3
	<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>110,6</b>	:	<b>-2,5</b>
2017	TM 1	114,4	1,1	5,2
	TM 2	114,3	-0,1	4,3
	TM 3	115,3	0,9	4,2
	TM 4	116,0	0,6	2,5
	<b>Mesatarja vjetore 2017</b>	<b>115,0</b>	:	<b>4,0</b>
2018	TM 1	116,0	0,0	1,4
	TM 2	117,0	0,9	2,4
	TM 3	117,9	0,8	2,3
	TM 4	120,5	2,1	3,8
	<b>Mesatarja vjetore 2018</b>	<b>117,8</b>	:	<b>2,5</b>
2019	TM 1	120,0	-0,4	3,5
	TM 2	121,6	1,3	3,9
	TM 3	120,5	-0,9	2,1
	TM 4	120,0	-0,3	-0,3
	<b>Mesatarja vjetore 2019</b>	<b>120,5</b>	:	<b>2,3</b>
2020	TM 1	119,3	-0,6	-0,6
	TM 2	117,3	-1,6	-3,5
	TM 3	117,7	0,3	-2,3
	TM 4	118,4	0,5	-1,4
	<b>Mesatarja vjetore 2020</b>	<b>118,2</b>	:	<b>-1,9</b>
2021	TM 1	122,3	3,3	2,5
	TM 2	126,4	3,4	7,7
	TM 3	135,0	6,8	14,7

**Fig. 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2015 – TM3 2021 (2010=100)**

**Tab. 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar**

Kodi	Grupi	pesha	TM3 - 2021	TM3 - 2021	TM3 - 2021
			2010 =100	TM2 - 2021	TM3 - 2020
<b>01-21</b>	<b>IÇIMP - Gjithsej</b>	<b>1000</b>	<b>135,0</b>	<b>6,8</b>	<b>14,7</b>
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	153,3	4,4	11,5
02	Produktet bimore	50	228,3	-1,0	9,9
03	Vajrat ushqyese	10	170,6	1,3	13,8
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	115,3	1,5	2,1
05	Produktet minerale	147	161,4	12,9	35,8
06	Produktet e industrive kimike	80	114,3	1,3	3,9
07	Plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre	64	145,5	3,5	19,9
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	121,0	-1,1	0,9
09	Druri dhe artikujt e tij	26	141,9	3,9	8,9
10	Letrat dhe artikujt e saj	16	98,4	-0,9	-3,6
11	Tekstili dhe artikujt e tekstit	44	81,6	1,6	-1,6
12	Këpucët	12	137,6	0,3	-3,0
13	Artikujt e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	130,1	4,8	11,4
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	161,3	33,5	56,9
16	Pajset e makinerisë dhe pajset elektrike	118	110,6	2,2	4,0
17	Mjetet e transportit	88	122,9	3,0	3,9
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	108,3	1,1	13,5
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	122,6	-0,7	1,6
21	Veprat e artit	:	:	:	:

## Shpjegime metodologjike

Çmimet grumbullohen në bazë tremujore në 7 qendra regjionale të Kosovës: Gjakovë, Gjilan Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj të cilat mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave.

Duke filluar nga tremujori i parë 2006, çmimet u grumbulluan në bazë tremujore për rreth 180 artikujt nga shtatëdhjetë kompani. Gjatë 2006 shumë vlerësime të reja të çmimeve u shtuan dhe për periudhën 2007-2008 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 250. Nga 2009 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 300, kurse nga viti 2015 numri i çmimeve është mbi 500 artikuj, ndersa nga 2018 numri i çmimeve të grumbulluara është rreth 600.

Rezultatet janë prezentuar sipas Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganeve (OBD).

Të dhënat e çmimeve janë grumbulluar për një mostër të transaksioneve tipike lidhur me mallrat e importuara në Kosovë

### Mostrimi dhe kalkulimi i peshave

Mostra është projektuar nga të dhënat e tregëtisë së jashtme. Këto të dhëna janë përdorur gjithashtu edhe për kalkulimin e peshave specifike. Peshat janë bazuar në informatën nga të dhënat tregëtare V-1 (viti paraprak) dhe janë freskuar në bazë vjetore. Me anë të freskimit të peshave për çdo vit, shporta e IÇIM-së do të reflektojë ndryshimet në mostrat e tregëtisë. IÇIM-ja do të ndikohet nga të dyja ndryshimet e çmimeve dhe nga ndryshimet e strukture së importit

### Variablët statistikor

Variabli kryesor është çmimi; ai mund të raportohet në çdo njësi monetare. Çmimet e raportuara në njësi të huaja monetare konvertohen në EURO. Njësia monetare e faturës dhe raportimit janë, prandaj si variabël plotësues. Kur çmimet raportohen në njësi të huaja monetare, atëherë përdoren tarifrat e këmbimit të mesatarës tremujore të Bankës Qendrore Suedeze për konvertimin e tyre në EURO.

### Formulat e indeksit

Indeksi i çmimeve të importit mund të përshkruhet si një indeks i llojit zinxhiror të Laspeyres-it me lidhje vjetore. Indeksi i Laspeyres-it definohet si në vijim.

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku  $P^0$  dhe  $P^t$  janë çmimet për njësi në periodën bazë (0) dhe perioda e krahasimit (t), përkatësisht, dhe  $Q^0$  është sasia e periodës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin qendror të mësipërm, indeksi shprehet me shkallën mes vlerës së mbledhur të shumave të periodës bazë në periodën e krahasimit dhe në nivelin e çmimit të periodës bazë, përkatësisht. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin final, si një mesatare e përafërt e çmimit të mallërave të peshuar me vlerat e periodës.



Çmimet e indeksit kalkuloohen me një tremujor aktual në vit si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin **y-1** si period e references së çmimit. Perioda e peshimit është viti **y-1**. Në këtë mënyrë lidhja definohet si:

$$I_{y-1,q4}^{y,q} = \sum_{s=1}^k \frac{V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{P_s^{y,q}}{P_s^{y-1,q4}}$$

Ku pasha e vlerës  $V_s$  është vlera e transakcioneve në vit e që përfaqësohen me specifikacionin **s**. Mbledhja bëhet nëpërmes specifikacioneve **k**.

Kalkulimi i indeksit zinxhiror të IÇIMP

Numri i indeksit zinxhiror kalkulohet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit krahasuar me nivelin e çmimit mesatar në 2010 (2010=100).

$$I_{2010}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2009,q4}^{2010,q}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,q4}^{Y,q4} \times I_{y-1,q4}^{y,q}$$

Kalkulimi i ndryshimeve

Ndryshimi tremujor kalkulohet si:

$$\left[ \left( \frac{IMPI_0^{Y,q}}{IMPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes tremujore}$$

$IMPI_0^{Y,q}$  = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_0^{Y,q-1}$  = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin e mëparshëm q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si:

$$\left[ \left( \frac{IMPI_{2010}^{Y,q}}{IMPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes vjetore}$$

$IMPI_{2010}^{Y,q}$  = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_{2010}^{Y-1,q}$  = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për vitin dhe për tremujorin paraprak q

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.